



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT

OPŠTINA LIPLJAN

MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATË /A	07.08.2016
REFERENCË	
PËR:	z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës në Lipjan
CC:	z. Fitim Selimi, Nënkyetar i Komunës në Lipjan z. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës në Lipjan
NGA:	z. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Lipjan
LËNDA:	Raport i punës - Muaji Korrik 01.07.2016–31.07.2016

Përgatitja e formularëve të personelit arsimor dhe dërgimi i tyre në MSHP dhe atë:

- Formular për ndryshime - kthim nga lehonja, kalimi në pushim lehonie, shtimi i licencimit,
- Formular për largim - skadim kontrate, pensionim,
- Formular për punëtor të rinjë,
- Të ndryshme - ndërrim i xhirrollogarisë.

Është bërë nënshkrimi i marrëveshjes mes Qendrës për Arsim KEC-it dhe Komunës së Lipjanit për implementimin e projektit “Më mëso mua”.

Përfituese nga Komuna jonë është shkolla “Ismail Luma” në Lipjan, e cila do të përfitoj:

- Pajisjen me 10 televizorë Smart TV e 10 klasave të mësimin,
- Parapagimin për dy vite shkollorë në platformën “Më mëso mua” i të gjithë mësimdhënësve dhe 500 nxënësve të shkollës,
- Përkrahjen profesionale lidhur me përdorimin e platformës në procesin mësimor.

Kërkesë PTK-së për rritjen e kapacitetit të internetit në Shfmu “Ismail Luma” në Lipjan, konformë marrëveshjes në mes Kec-it dhe Komunës së Lipjanit, për realizimin e projektit “Më mëso mua”.

Në Shfmu “Vllëzërit Frashëri” në Lipjan është bërë furnizimi me paisje pune për kabinetin e Tik-ut, e cila ka qenë bashkëfinancim nga Komuna e Lipjanit dhe BE-ja.

Takim me përfaqësuesit e UNDP-së ku qëllimi i takimit ishte shkëmbimin e informatave rreth trajnimeve për trashëgiminë kulturore, të parapara të zhvillohen në kuadër të kornizës zbatuese të projektit gjatë muajve në vijim, me të rinjët/nxënësit e Komunës sonë.

Ka filluar instalimi i nxemjeve qendrore në këto shkolla:

- Shfmu “Migjeni” në Rufe i Ri,
- Shfmu “Shtjefën Gjeçovi” në Janjevë,
- Shfmu “Dy Dëshmorët” në Dobraje e Madhe,
- Shfmu “Hasan Zyko Kamberi” në Sllovi,
- Shfmu “Ernest Koliqi” në Babush i Muhaxherëve dhe
- Shfmu “Katër Dëshmorët” në Krojmir.

Rregullimi - ndërrimi i dyerve dhe dritareve në:

- Shfmu “Zenel Hajdini” në Gadime, p.n.f Marevc,
- Shfmu “Vllezërit Domaneku” në Topliqan, p.n.f Grackë dhe
- Shfmu “Vllezërit Frashëri” në Lipjan p.n.f Konjuh.

Kërkesë Drejtoratit të Prokurimit - fillimin e procedurave për:

- Furnizimin e shkollave me material të mirëmbajtjes & paisje, transportin e nxënësve në relacione të ndryshme nga vendbanimi në shkollë dhe anasjelltas si dhe transportin e nxënësve me nevoja të veqanta në realcionin shkollë dhe anasjelltas (kontratë kornizë 2016-2019).
- Riparimin e objektit të shkollës së vjetër (ish Gjumnazi Ulpiana) në Lipjan,
- Furnizimi me inventar për shkolla të reja Shfmu “Nezë Bujani” në Bujan dhe Shfmu “Emin Duraku” në Banullë, p.n.f Gumnasellë.

Kanë përfunduar përgatitjet e kërkesave për furnizimin me libra për vitin shkollor 2016-2017 (konformë kërkesës nga MASHT-i).

Organizata Patient Help fund (PHF) ka bërë hapjen e pusit -bunarit në SHML Gjumnazi “Ulpiana” në Lipjan, duke përfshirë edhe paisje tjera të nevojshme - përcjellëse.

Përfundimi i korrje-shirjeve të grurit në SHMP “Adem Gllavica” në Lipjan (Ekonominë Bujqësore).

Shpallja e konkursit të rregulltë për plotësimin e vendeve të lira të punës në disa shkolla.

Nënalokimi në kategorinë: Paga, Mallra&Shërbime dhe Komunali.

Zotimi i mjeteve në kategorinë: Mallra&Shërbime dhe Komunali.

Kalkulimi i padive gjyqësore.

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.